



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 871/6 Prot.

Vlorë, më 01.07.2019

VENDIM

Nr. 29, datë 01.07.2019

PËR

RIEMËRTIM TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË NË LËNDËN GJUHË ANGLEZE", "MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË NË LËNDËN GJUHË ITALIANE" NË "MASTER NË MËSIMDHËNIE NË GJUHË ANGLEZE" DHE "MASTER NË MËSIMDHËNIE NË GJUHË ITALIANE"

Mbështetur në pikën 2 të nenit 83, shkronjën dh të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Senatit nr. 48, datë 17.07.2018 "Për miratimin e ndryshimeve në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze" dhe Vendimin e Senatit nr. 49, datë 17.07.2018 "Për miratimin e ndryshimeve në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë italiane", shkresën e MASR-së me nr. 971/3 prot, datë 21.09.2018, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 01.07.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja me nr. 204, datë 21.06.2019, për ndryshimin e emërtimeve të programeve: "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze", "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë italiane" në "Master në mësime të gjuhë angleze" dhe "Master në mësime të gjuhë italiane" pasi pas përshtatjes nga programe me 90 kredite në programe me 120 kredite (Vendim Senati nr. 48, datë 17.07.2018 dhe Vendim Senati nr. 49, datë 17.07.2018, shkresë e MASR-së me nr. 971/3 prot, datë 21.09.2018), emërtesat e tyre duhet gjithashtu të jenë në përputhje me pikën 2 të nenit 83 të ligjit 80/2015, e cila parashikon që: "Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Efektet e ndryshimeve në emërtesë të prekin edhe studentët që kanë filluar studimet në këto programe në vitin akademik 2018-2019.
3. MASR do të njoftohet me shkrim për ndryshimet e bëra në emërtesa në këto programe studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

